



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 12 Prot.

Tiranë më 13/01 /2017

Proces-verbal

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Sot, në datën 13.1.2017 në orën 12:00, në ambientet e “Ministritsë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes” u mbajt mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së. Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashikonte:

1. Diskutimi i prioriteteve të Thirrjes Nr. 10;
2. Shpallja e Thirrjes Nr. 10;
3. Miratimi i Raportit Vjetor për vitin 2016

Në mungesë të Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së, morën pjesë z. Erion Banushi – Përgjegjës i “Sektorit të Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit” dhe z. Altin Mjollli – Specialist për Arkivimin dhe Komunikimin pranë KSHC-së, si dhe si edhe anëtarë të Bordit si më poshtë :

1. Z. Adrian THANO
2. Z. Alban DUDUSHI
3. Z. Aldo MERKOCI
4. Z. Ismail ADEMI
5. Znj. Kozara KATI
6. Z. Endri FUGA
7. Znj. Gelardina PRODANI
8. Znj. Albana KOCIU

Kryetari i BM, z. Adrian Thano, pasi verifikon se është plotësuar kuorimi i nevojshëm, deklaron të hapur mbledhjen në orën 12:00.

Menjëherë Kryetari i jep fjalën znj. Kozara KATI, e cila pasi përshëndet fillon diskutimin duke vënë theksin se në këtë Thirrje duhet të ketë një zë të veçantë Reforma në Drejtësi.

Ajo shprehet: Reforma në Drejtësi mund të shihet në një plan më të gjerë për të ndërgjegjësuar qytetarin. Gjithçka që ka të bëjë me Reformën në Drejtësi hyn në atë bllok qoftë në pushtetin vendor dhe atë qendror, ndaj si prioritet i Qeverisë, por dhe i qytetarit kjo pikë është e

rëndësishmë. P.sh. organizata që merren me çështje juridike si dhe ato të të drejtave të njeriut duke e parë në këndvështrimin e tyre mund të përfshihen duke u fokusuar tek transparenca, llogaridhënia, integriteti në mënyrë që të ndiqet sa më profesionalisht zbatimi i kësaj reforme.

Kjo lëvizje të promovohet jo vetëm nga media, por të jetë risi në Thirrjen tonë për t'u promovuar kështu edhe nga organizatat duke u fokusuar në mekanizmat e reja të shkatërrimit të korrupsionit. Pra të specifikohet si risi e Thirrjes dhe që të jetë në funksion të një përqindje të caktuar të fondit.”

Ndërhyn z. THANO duke u shprehur se nuk ka nevojë të përcaktojmë një përqindje.

Znj. KATI vazhdon duke thënë se Reforma në Drejtësi nuk është pronë e Qeverisë, por e të gjithëve, ndaj përfshirja e shoqërisë civile ka mjaft rëndësi pasi ajo ka më shumë mundësi të punojë në terren. Formula të jetë pak inteligjente për sa i përket pjesëmarrjes në zbatim, monitorimit, këkesave ligjore dhe transparencës në funksion të përfshirjes së shoqërisë civile në këtë proces.

Z. THANO thotë: “Cilat target mund t’i afrohet këtij prioriteti?”

Znj. KATI ia kthen se ka mjaft organizata sidomos ato të drejtave të njeriut.

Z. THANO pyet: “Por si mund ta ndihmojë një OJF një viktimë të gjyqësorit?”

Z. KATI i përgjigjet se ka plot raste, si për shembull një rast nga Durrësi, ku personi e humbiste gjithmonë gjyqësorin, por i ndihmuar nga qendra sociale dhe duke qenë prezent në procesin gjyqësor u bë e mundur t’i jepej një shans “viktimës” që të ishte prezent si dhe një garanci më tepër për transparencën.

Ndërhyn z. ADEMI, sipas të cilit të promovosh klinika ligjore është një mënyrë për vënien në zbatim të këtij prioriteti.

Z. FUGA shprehet: “Mendoj të vendosim një kriter më gjithëpërfshirës për reformën në drejtësi dhe gjyqësor duke patur parasysh rëndësinë e secilës çështje. Të monitorohen institucionet e reja që do krijohen.”

Z. ADEMI vazhdon: “Mendoj ta lëmë të përgjithshme këtë pikë duke vendosur si prioritet fuqimin e rolit të shoqërisë civile në shtetin e së drejtës.”

Më pas diskutohen përmbledhja e sugjerimeve për prioritetet të mbledhura nga takimet konsultative të AMSHC-së me organizatat e shoqërisë civile në rrethe si edhe të sugjerimet e mbledhura elektronikisht deri më datë 10.1.2017.

Si përfundim anëtarët hedhin idenë që stafi i AMSHC-së nisur nga sugjerimet e marra të bëjë një përmbledhje me tema më gjithëpërfshirëse si: rinia, ekonomia, shteti i së drejtës, mjedisi.

Z. ADEMI në vazhdim të kësaj, sugjeron që si pjesë e prioritetëve të jenë edhe çështje që kanë të bëjnë me emigracionin dhe diasporën.

Z. THANO pyet për fondin e këtij viti dhe sa projekte kanë mbetur për t'u financuar dhe propozon që projektet që do të vijnë për këtë vit të mbyllen të gjitha brenda vitit, për të mos patur prapambetje. Pra nëse ne shpallim thirrjen sot dhe një muaj është koha e aplikimit, të gjitha projektet të mos jenë më të gjata se tetë muaj dhe të përfundojnë brenda datës 31.12.2017, në mënyrë që të jenë sa më dinamike dhe rezultative.

Z. ADEMI pyet nëse duhet të vendosim limit shume meqënëse kohëzgjatja e projektit do të jetë më e shkurtër.

Në përfundim të mbledhjes anëtarët ranë dakord unanimisht që me përfundimin dhe paraqitjen e përmbledhjes së prioritetëve për Thirrjen Nr. 10, të bëhet edhe shpallja publike e kësaj thirrje, miratuan Raportin Vjetor të Institucionit për vitin 2016 si dhe autorizuan Drejtorin Ekzekutiv, që sipas nevojës, të mundësojë punësimin e stafit për AMSHC-në për vitin 2017 duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Mbledhja u deklarua e mbyllur në orën 13:00.